

6.20 Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

BE promovon fuqishëm aktivitetet e ndryshimeve klimatike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Legjislacioni i BE-së përmban dispozita që adresojnë ndryshimet klimatike, cilësinë e ajrit dhe ajrit, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e natyrës, ndotjen industriale, kimikatet, zhurmën dhe mbrojtjen civile.

Kosova është në **fazë të hershme të përgatitjes** në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Gjatë periudhës raportuese është arritur **progres i kufizuar**. Ka pasur përmirësime në raportimin mjedisor dhe monitorimin e cilësisë së ajrit. Nevojitet vullnet më i fortë politik për të adresuar degradimin e mjedisit dhe sfidat ndaj ndryshimeve klimatike. Shumica e rekomandimeve nga raporti i mëparshëm janë ende në pritje. Kosova inkurajohet që në vitin e ardhshëm, të rritë në mënyrë të konsiderueshme ambiciet drejt tranzicionit të gjelbër, në veçanti duhet:

- të vendos sistem efektiv të monitorimit të ujit, të publikoj të dhëna dhe ndërmerr masa urgjente dhe të përhershme për të zvogëluar ndotjen e ajrit dhe ujit;
- të vazhdojë të rrisë mbulueshmërinë e grumbullimit të mbeturinave, veçanërisht në ndërhyrjen e ndarjes së mbeturinave dhe riciklimin, të prezantojë masa të ekonomisë qarkore për të zvogëluar mbeturinat dhe të adresoj çështjen e deponive të paligjshme;
- të zbatojë dispozitat ligjore për përgjegjësitë, dëmet dhe krimet mjedisore; të zbatoj parimin ndotësi paguan si dhe të krijoj dhe filloj një fushatë të përhershme për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit;
- të zbatojë strategjinë dhe planin e veprimt për ndryshime klimatike, të përgatisë një udhërrëfyes për përafrimin me acquis të BE-së për klimën dhe të fillojë punën për përgatitjen e planit të energjisë dhe klimës, në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë.

Mjedisi

Sa i përket **çështjeve horizontale**, Kosova duhet të përditësoj dhe zbatojë strategjinë e mjedisit 2011-2021. Financimi i pamjaftueshëm dhe kapacitetet administrative pengojnë zbatimin e duhur të kornizës aktuale strategjike. Mungesa e përafrimit me Direktivën e Përgjegjësisë Mjedisore ulë efektivitetin e mbrojtjes së mjedisit. Ka pasur përparime në fuqizimin e dispozitave të Kodit Penal për krimet mjedisore, por që kanë mbetur joefektive deri më sot. Inspektorati mjedisor nuk ka kapacitet për zbatim efektiv. Zbatimi i ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të përmirësohet në masë të konsiderueshme. Koordinimi ndërinstytucional dhe përfshirja e shoqërisë civile mbetet e kufizuar. Ngritja e ndërgjegjësimit kryesisht i lihet komunitetit ndërkombëtar dhe organizatave të shoqërisë civile. Disa investime të planifikuara janë anuluar ose shtyrë për shkak të vonësave në përcaktimin e lokacioneve ose mungesës së burimeve për funksionimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës.

Cilësia e ajrit vazhdon të paraqesë kërcënim të madh për shëndetin. Autoritetet kanë dështuar të miratojnë dhe zbatojnë masa për ta përmirësuar atë, veçanërisht përmes planit të zvogëlimit të emetimeve. Strategjia e cilësisë së ajrit nuk është zbatuar ende. Ndotja e pakontrolluar, sidomos nga termocentralet e vjetruara, sistemi i ngrohjes qendrore, trafiku, emetimet

industriale dhe djegia e mbeturinave dhe materialeve të tjera toksike kërkon masa urgjente. Masat për të zbatuar ndalimin e thëngjillit për ngrohje nuk janë efektive dhe duhet të ofrohen subvencione për forma tjera të ngrohjes.

Ende nuk janë përgatitur planet e cilësisë së ajrit për zonat në të cilat nivelet e ndotësve tejkalojnë dukshëm vlerat kufitare. Ka pasur progres në monitorimin e cilësisë së ajrit në kohë reale.

Sistemi i **menaxhimit të mbeturinave të ngurta** vazhdon të jetë i paqëndrueshëm. Korniza ligjore është pjesërisht e përafëruar me acquis të BE, por janë të nevojshëm aktet nënligjore për të zgjeruar përgjegjësinë e prodhuesit dhe parimin ndotësi paguan. Ligji për mbeturinat duhet të harmonizohet më tej me Direktivën Kornizë të Mbeturinave. Zbatimi është i mangët dhe shumica e mbeturinave përfundojnë në deponi të paligjshme ose që nuk menaxhohen si duhet. Pavarësisht përpjekjeve për të shpëtuar nga vendgrumbullimet e paligjshme, ato vazhdojnë të përhapen (nga 1,572 në vitin 2017 në 2,529 në vitin 2019) dhe paraqesin rrezik serioz për shëndetin publik, veçanërisht për shkak të mbeturinave të rrezikshme dhe ndotjes së ujërave nëntokësore. Parandalimi dhe monitorimi i mbeturinave mbetet sfidë. Shkalla aktuale e grumbullimit të mbeturinave është 70% dhe më pak se 40% e mbeturinave të ngurta hidhen në objekte të menaxhuara. Kosova duhet të prezantojë masa ligjore dhe praktike për të zvogëluar mbeturinat dhe për të rritur riciklimin dhe rigjenerimin në përputhje me parimet e ekonomisë qarkore. Planet e menaxhimit të mbeturinave komunale ende nuk janë miratuar nga të gjitha komunat. Strategjia dhe plani i veprimit të menaxhimit të mbeturinave 2013-2022 pasqyrohen vetëm pjesërisht në dokumentet e planifikimit lokale. Liqeni i depozitës së hirit të qymyrit që operohet nga Kompania Elektroenergjetike e Kosovës dhe deponia e Mirashit në Obiliq duhet të mbyllet dhe rehabilitohen urgjentisht dhe përgjithmonë.

Nuk ka pasur progres në përafrimin e legjislacionit të **ujërave** me acquis të BE-së. Kosova ka strategjinë për ujërat 2017-2036, por niveli i përafrimit me legjislacionin e BE mbetet shumë i ulët. Duhet bërë më shumë për të siguruar zbatimin e ligjit të ujërave. Rrjetet e monitorimit të burimeve ujore nuk janë kompletuar ende, veçanërisht për ujërat nëntokësore si dhe zonat e mbrojtura të ujit nuk po monitorohen ose menaxhohen siç duhet. Kërkohej përpjekje urgjente për të siguruar që autoriteti rajonal i pellgut lumor të funksionalizohet. Nuk është arritur asnjë progres në përgatitjen e planeve të menaxhimit për të gjitha pellgjet lumore. Ka pasur progres në bashkëpunimin me vendet fqinje për menaxhimin e integruar të ujërave dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Është arritur progres në planifikimin dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Duhet të përmirësohet inkasimi i tarifave si dhe të zvogëlohen humbjet e ujit, veçanërisht humbjet komerciale. Siguria dhe menaxhimi i digave janë joadekuate, siç janë edhe hartat e parandalimit të rrezikut nga përmbytjet. Mungesa e pajisjeve të trajtimit tregon se ujërat e ndotura të pa trajtuara dhe shkarkimi i tyre mbeten burimet kryesore të ndotjes së ujit. Kosova duhet të identifikojë aglomeratet dhe zonat e ndjeshme, në përputhje me Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Zeza Urbane. Menaxhimi i digave të rezervuarit të ujit duhet të përmirësohet për të plotësuar nevojat për ujë, veçanërisht duke marr parasysh tensionin e ujit që rezulton nga ndryshimet klimatike. Efekti kumulativ i ndërtimit të shumë hidrocentraleve të vogla dëmton mjedisin.

Plani i veprimit të biodiversitetit 2016-2020 zbatohet vetëm pjesërisht. Nuk është arritur progres në fushën e **mbrojtjes së natyrës**. Kosova është bërë anëtare e Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe ka zgjeruar statusin e zonave të mbrojtura në shumicën e territorit të saj.

Megjithatë, ato janë të ndotura dhe mirëmbahen dobët. Kosova ka ndërmarrë hapa për të filluar inventarizimin dhe shenjëzimin e habitateve natyrore dhe biodiversitetit, por përcaktimi i vendeve Natura 2000 është ende në fazë shumë të hershme për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative. Është arritur progres në sektorin e pylltarisë në planifikim dhe menaxhim, me miratimin e akteve përkatëse nënligjore. Shpyllëzimet dhe prerjet ilegale mbeten problematike.

Asnjë zhvillim nuk është shënua në përputhjen me acquis të BE për **ndotjen industriale dhe menaxhimin e rrezikut**, i cili mbetet në një fazë të hershme. Zbatimi i pamjaftueshëm i legjislacionit dhe përgjegjshmëria e ndotësve po pengon krijimin e një sistemi për parandalimin e aksidenteve industriale dhe kimike. Mbeturinat e rrezikshme të minierave, shkarkimet industriale në lumenj dhe deponitë industriale vazhdojnë të paraqesin kërcënime serioze për tokën dhe ujin. Ende nuk është përcaktuar lokacioni për magazinën ruajtjes së mbetjeve të rrezikshme.

Nuk është shënua progres në lidhje me **kimikatet**, ku përafrimi me acquis e BE-së mbetet në fazë të hershme. Kosova nuk është palë e Konventës së Roterdamit dhe duhet të zbatojë kornizën rregullative për eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme. Ende nuk është krijuar një pik ndihmëse (helpdesk) dhe një qendër për kontrollimin e helmimeve kimik.

Kosova nuk ka legjislacion për **zhurmën** dhe nuk ka pasur zhvillime në këtë fushë.

Kosova nuk është pjesë e **Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit**, por përfiton nga programet rajonale të mbrojtjes civile nën Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit. Kosova gjithashtu mund të përfitojë nga mjete të caktuara nën Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit siç janë trajnimet, aktivitetet, projektet e parandalimit dhe gatishmërisë si dhe shkëmbimin e ekspertëve. Ende nuk është krijuar një qendër operationale dhe një sistem i komunikimi emergjent. COVID-19 nxjerr në pah nevojën për të forcuar kornizën ligjore dhe kapacitetet institucionale, si dhe burimet njerëzore dhe financiare të autoriteteve të mbrojtjes civile edhe për sa i përket urgjencave shëndetësore. Kosova inkurajohet të marrë pjesë më aktive në aktivitetet nën Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit (UCPM), siç janë trajnimet, shkëmbimi i ekspertëve, projektet e parandalimit dhe gatishmërisë, ushtrime si dhe misione këshilluese.

Ndryshimet klimatike

Zbatimi i strategjisë së **ndryshimeve klimatike** ende mbetet në një fazë të hershme. Kosova mbështetet fuqishëm në thëngjill dhe nuk është në përputhje me kufijtë e emetimeve të vendosura në Planin Kombëtar të Reduktimit të Emetimeve (NERP).

Kosova nuk ka arritur progres në përafrimin me legjislacionin e BE-së. Akoma nuk ka strategji për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike. Këshilli Kombëtar për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike dhe Koordinatorin e Ndryshimeve Klimatike nuk ka ndërmarr masa konkrete për të përfshirë veprimet klimatike ose për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, dhe ka pak dëshmi të politikave që përputhen me objektivat e ndryshimeve klimatike. Kapaciteti administrativ dhe ngritja e vetëdijes duhet të forcohen në mënyrë të konsiderueshme në të gjitha nivelet. Strategjia dhe plani i veprimit për ndryshimet klimatike 2019-2028 nuk janë zbatuar siç duhet.

Meqë Kosova nuk është nënshkruese e Konventës Kornizë të OKB për Ndryshimet Klimatike, për këtë arsye edhe nuk ka kontribut të përcaktuar kombëtar sipas Marrëveshjes së Parisit 2015, zbatimi i plotë i strategjisë së saj për ndryshime klimatike duhet të shërbejë si një udhëzues për arritjen e objektivave të Marrëveshjes.